

2014-05-09

Informacion pacientit, bakteret ESBL-krijuese Fletë e mjekut për sëmundjet ngjitëse

Ç'është ESBL?

ESBL do të thotë "extended spectrum betalactamases". Janë materie (enzima) të cilat mund të krijohen nga bakteret e zorrëve. Këto baktere zbërthejnë antibiotikun e zakonshëm, p.sh. penicilinën. Kështu pra, bakteret ESBL-krijuese, bëhen rezistuese ndaj këtij lloji të antibiotikut. Ndërkaq, këto mund të trajtohen me lloje të tjera antibiotiku, **nëse** ato do të shkaktonin një infeksion. Të gjithë njerëzit kanë baktere në zorrë, të ashtuquajtur florën normale të zorrëve. Është e nevojshme që të zbërthejnë ushqimin dhe është me rëndësi për imunitetin. Bakteret ESBL-krijuese, janë baktere të zorrëve, të cilat mund të përfshihen nga flora e zorrëve, për një kohe të shkurtër apo të gjatë.

A ekzistojnë rreziqe me ESBL?

Rreziku më i madh i baktereve kundër rezistuese ndaj antibiotikut është se mund të mos marrësh antibiotikun e drejtë, në rast të një infeksioni. Shumica e personave me baktere ESBL-krijuese, i kanë ato në zorrë, pa qenë i/e sëmurë, i ashtuquajtur **bartës**. Bartja nuk është një sëmundje dhe ajo nuk duhet trajtuar. Bakteret ESBL-krijuese nuk shkaktojnë më shpesh sëmundje se sa bakteret e tjera. Nëse bakteret ESBL-krijuese shkaktojnë **sëmundjen**, është shpesh ajo sëmundja e infeksionit të zakonshëm të kanaleve të ujit, por mund të jenë edhe lloje të tjera të infeksioneve. Dallimi është, se në rast të infeksionit me baktere ESBL-krijuese, duhet të trajtohesh me lloje të tjera të antibiotikut. Ndonjëherë do të thotë të mjekohesh i shtrirë në spital, në vend që të marrësh tableta në shtëpi.

Si përhapet ESBL-i?

Për t' u bërë bartës i baktereve ESBL-krijuese, duhet të futen përmes gojës. Mund të infektohesh përmes ushqimit dhe ujit, të cilat janë të ndotura me bakteret e zorrëve, para së gjithash me rastin e një udhëtimi jashtë shtetit. Po ashtu, bakteret përhapen përmes duarve, pas vajtjes në nevojtoje. Edhe në kujdesin shëndetësor mund të përhapen bakteret ESBL-krijuese, nga një plagë dhe nga katetet (qese e urinës), në mes pacientëve, para së gjithash përmes duarve.

A mund të zhduken ESBL?

Meqë bakteret e zorrëve ESBL-krijuese bëhen një pjesë normale e florës së zorrëve, mund të jesh bartës i tyre për një kohë të gjatë (muaj-vite). Nuk mund të thuhet tani për tani se sa gjatë ke bartë bakteret, por shumicës së njerëzve besohet se me kalimin e kohës ju zhduken ato. Kontrollimi i nevojës së madhe zakonisht nuk është i nevojshëm.

Çka është mirë të kesh parasysh?

- Higjiena e duarve është po aq e rëndësishme si gjithmonë. Laj duart me sapun dhe ujë, pas vajtjes në nevojtoje dhe para se përgatitësh ushqimin/ngrënies. Sapuni i lëngshëm është gjithmonë më i preferuari.
- Ti, nuk ke nevojë të informosh dikë në afërsinë tënde se ti je bartës i baktereve ESBL-krijuese.
- Ti, mund të jetosh si zakonisht dhe të shoqërohesh me njerëzit e tjerë. Ti, po ashtu, mund të kesh marrëdhënie seksuale, si zakonisht.
- Nëse ti ke plagë, katete të urinës ose ke stomi (qese e nevojës së madhe), është jashtëzakonisht e rëndësishme t' i lash duart pas ndërrimit/rivendosjes së tyre. Është, po ashtu, mirë të bësh dush, në vend që të lahesh në vaskë/pishinë.

2014-05-09

- Nëse ti ke diarré ose rrjedhje të nevojës së madhe, është, po ashtu, mirë të bësh dush, në vend që të lahesh në vaskë/pishinë.
- Nëse ti ke nevojë të trajtohesh me antibiotik, është shumë me rëndësi që të marrësh llojin e drejtë të antibiotiku dhe të merret provë e kultivimit të baktereve. Për hir tënde, ju lutemi pra të informosh mjekun/dentistin tënd se ti je bartës/je më herët i infektuar.
- Nëse ti shtrihesh në spital, ku do të bësh operacion ose do të qëndrosh në një banim të veçantë, do të ishte mirë t' i tregosh mjekut se ti ke pasur baktere ESBL-krijuese. Në mjekësinë dhe në banimin e veçantë, është e rëndësisë së veçantë me kujdesin për higjienën dhe për rutinat e pastrimit, që bakteret mos të përhapen tek të tjerët.